



Prishtinë, 04.10.2021
Kodi i ZRRE-së:V_1427_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënpar. 1.7, nenin 15, nenin 16, nenin 25 dhe nenin 26 paragrafi 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 1 nënpar.1.34 dhe nënpar.1.41, nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Nenin 16 i licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe
- Kërkesën e KOSTT të datës 06.04.2021 për aprovimin e dokumentit *Metodologjia për vlerësimin e NTC në linjat interkonektive të Kosovës*,

në seancën e mbajtur me 04 tetor 2021, nxori këtë:

V E N D I M

I APROVOHET – kërkesa e KOSTT SH.A. “Metodologjia për vlerësimin e NTC në linjat interkonektive të Kosovës”.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.04.2021 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e dokumentit *Metodologjia për vlerësimin e NTC në linjat interkonektive të Kosovës*.

Metodologjia zbatohet nga KOSTT për kalkulimin e vlerave vjetore, mujore dhe ditore të Kapacitetit Neto të Transmetimit (NTC) në linjat interkonektive të Kosovës (Kosovë- Serbi, Kosovë-Maqedoni, Kosovë- Shqipëri dhe Kosovë- Mali i Zi) bazuar në simulimet kompjuterike të rrjedhave të fuqisë në modelin e përbashkët të transmetimit i cili merr për bazë topologjinë aktuale dhe kushtet e operimit të regjionit të Evropës Jug-Lindore.

Kalkulimet përcaktojnë bazat e alokimit të së drejtës së shfrytëzimit të kapacitetit të çdo linje interkonektive, si dhe i referohet kalkulimit të kapacitetit të transmetimit për kushtet e importit apo eksportit nga linjat interkonektive të Kosovës.

Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës së KOSTT SH.A., dokumentit - *Metodologjia për vlerësimin e NTC në linjat interkonektive të Kosovës*, ka vlerësuar se dokumenti duhet të aprovohet, dhe duke u



mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Ymer Fejzollahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet palëve:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.